



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0619

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE AgriBau SH.P.K. kundër Njoftimitin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ritenderim Subvencionimi i fermëve kultivues të perimeve në serra dhe jashtë tyre me pajisje ” me numër të prokurimit:656-25-5673-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna Ferizaj, më 03/09/2025, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE AgriBau SH.P.K.me nr. 2025/0619 e datës 08/07/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ritenderim Subvencionimi i fermëve kultivues të perimeve në serra dhe jashtë tyre me pajisje” me numër të prokurimit:656-25-5673-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK)Komuna Ferizaj, **ndërsa AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.**
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
4. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 24.06.2025 Komuna Ferizaj në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ritenderim Subvencionimi i fermave kultivues të perimeve në serra dhe jashtë tyre me pajisje” me numër të prokurimit: 656-25-5673-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 170,000.00 €.

Me 03.07.2025, OE AgriBau SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Kurse me datën 04.07.2025 i është aprovuar si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues.

Me 08.07.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE AgriBau SH.P.K. me nr. 2025/0619 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ritenderim Subvencionimi i fermave kultivues të perimeve në serra dhe jashtë tyre me pajisje” me numër të prokurimit: 656-25-5673-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues AgriBau SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Ankimor 1

Operatori Ekonomik “AGRIBAU SH.P.K.” pretendon se Autoriteti Kontraktues ka përfshirë në paramasë specifikime teknike të fiksuara dhe kufizuese, të cilat nuk lejojnë toleranca të arsyeshme për produktet e ofertës, si në rastin e motokultivatorit me specifikim fiks “7.1 HP” dhe dimensioneve të frezave me gjerësi të përcaktuar saktësisht (p.sh. 1200–1202 mm, 980–982 mm, etj.). Sipas ankuesit, këto kërkesa kufizojnë konkurrencën dhe favorizojnë produkte të një prodhuesi të caktuar, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenet 19.1, 19.4 dhe 19.6 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Pretendimi 2

Kjo pikë u pranua pjesërisht nga AK pas kërkesës për rishqyrtim dhe është larguar nga dosja – përfshin kërkesën për agronom të diplomuar (nuk është përshkruar në mënyrë të detajuar në ankesë).

Pretendimi Ankimor 3

Ankuesi “AGRIBAU SH.P.K.” konteston kërkesën e AK-së për dorëzimin e A-testeve nga prodhuesi në fazën e ofertimit, së bashku me certifikatën CE ose deklaratën e konformitetit. Sipas ankuesit, kjo kërkesë është e paarsyeshme dhe jo proporcionale, pasi pajisjet mund të mos jenë prodhuar ende në kohën e ofertimit dhe, për rrjedhojë, raportet e A-testeve nuk mund të jenë të gatshme. Ankuesi thekson se certifikata CE është dokument zyrtar që dëshmon përputhshmërinë e produktit me standardet evropiane, dhe se kërkesa për A-test që në këtë fazë është e panevojshme, veçanërisht kur nuk ka ndonjë rrezik të veçantë teknik që ta justifikojë. Më tej, ankuesi përmend se në një tender paraprak të ngjashëm, mungesa e A-testit ishte përdorur si arsye për eliminimin e ofertës së tyre, edhe pse kishin dorëzuar dokumente të tjera të përputhshmërisë. Sipas tyre, kjo dëshmon se kërkesa nuk është vendosur për të verifikuar cilësinë teknike reale, por për të përjashtuar ofertues të caktuar. Po ashtu, A-testet që janë dorëzuar nga ofertues të tjerë në tender janë lëshuar nga një prodhues tjetër nga ai që ka dhënë autorizimin zyrtar për ofertim, gjë që nuk është ndëshkuar nga AK, duke krijuar trajtim të pabarabartë. Në përfundim, ankuesi vlerëson se kërkesa për A-test në fazën e ofertimit është jo proporcionale, e panevojshme dhe kufizuese për konkurrencën, në kundërshtim me nenin 7 dhe 28 të LPP-së dhe kërkon heqjen e saj nga dosja e tenderit.

Pretendimi Ankimor 4

OE ankues kundërshton kërkesën e Autoritetit Kontraktues për dorëzimin e certifikatave ISO 9001:2015, ISO 45001:2018 dhe ISO 14001:2015 nga prodhuesi i pajisjeve. Ankuesi argumenton se këto janë certifikata të sistemit të menaxhimit, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e pajisjeve të ofertës. Sipas tij, nëse kërkesa për këto certifikata konsiderohet e arsyeshme, atëherë ato duhet të vlejnjë për vetë operatorin ekonomik ofertues dhe jo për prodhuesin, pasi një OE mund të ofrojë produkte të certifikuara edhe nëse prodhuesi nuk i zotëron këto standarde. Kërkesa konsiderohet kufizuese, jo proporcionale dhe në kundërshtim me nenin 7 dhe 28 të LPP-së, si dhe me nenin 19.6 të RrPP, për shkak se nuk është paraparë opsioni “ose ekuivalente”.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 14/07/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0619/2025, ndërsa me datë 14/07/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 0619/2025, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “AgriBau SH.P.K.eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0619 ka vlerësuar si në vijim:

PËRSHKRIMI I ANKESËS

Operatori Ekonomik AGRIBAU SH.P.K. ka paraqitur ankesë kundër Komunës së Ferizajt për aktivitetin e prokurimit “Ritenderim - Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në sera dhe jashtë tyre me pajisje”. Ankuesi pretendon se dosja e tenderit përmban specifikime teknike diskriminuese dhe të fiksuara që kufizojnë konkurrencën, kërkesa të paarsyeshme për A-teste dhe certifikata ISO nga prodhuesi, si dhe trajtim të pabarabartë në procesin e rishqyrtimit. Në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur më datë 03.07.2025, ankuesi ka paraqitur katër pretendime, prej të cilave një është pranuar nga Autoriteti Kontraktues dhe është reflektuar në ndryshimin e dosjes së tenderit, ndërsa tri pretendimet e tjera janë refuzuar dhe mbetur në fuqi. Ankuesi thekson se ky veprim i pjesshëm i AK-së nuk është i mjaftueshëm dhe se kërkesat e mbetura janë po aq kufizuese dhe të paarsyeshme sa edhe ajo që u pranua dhe u korrigjua. Për këtë arsye, ai kërkon ndërhyrjen e OSHP-së për të korrigjuar shkeljet ligjore dhe për të siguruar një proces të drejtë, proporcional dhe konkurrues.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të paraqitura nga OE “AGRIBAU SH.P.K.” kundër Komunës së Ferizajt për aktivitetin e prokurimit “Ritenderim – Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në sera dhe jashtë tyre me pajisje”. Pas shqyrtimit të dosjes së tenderit, vendimit të Autoritetit Kontraktues mbi kërkesën për rishqyrtim, si dhe dokumentacionit të dorëzuar nga pala ankuese, eksperti shqyrtues paraqet vlerësimet si më poshtë:

Pretendimi Ankimor 1

Operatori Ekonomik “AGRIBAU SH.P.K.” pretendon se Autoriteti Kontraktues ka përfshirë në paramasë specifikime teknike të fiksuara dhe kufizuese, të cilat nuk lejojnë toleranca të arsyeshme për produktet e ofertës, si në rastin e motokultivatorit me specifikim fiks “7.1 HP” dhe dimensioneve të frezave me gjerësi të përcaktuar saktësisht (p.sh. 1200–1202 mm, 980–982 mm, etj.). Sipas ankuesit, këto kërkesa kufizojnë konkurrencën dhe favorizojnë produkte të një prodhuesi të caktuar, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenet 19.1, 19.4 dhe 19.6 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 1

Pas shqyrtimit të pretendimit dhe dokumentacionit të dosjes së tenderit të publikuar në platformën e-prokurimit, eksperti shqyrtues konstaton se, sipas paramasës së publikuar nga

Autoriteti Kontraktues, për artikullin në fjalë janë kërkuar specifikime shumë të sakta dhe me toleranca minimale, si vijon:

- Fuqia e motorit: 7.1 HP
- Rrotullime (RPM): 3600
- Dimensionet: 1548-1555/1248-1255/1046-1055
- Gjerësia e punës duhet të jetë me mundësi të përshtatjes në katër nivele: 1200–1202 mm, 980–982 mm, 749–751 mm, 529–531 mm
- Diametri i setit të tehave/frezës: 358–363 mm

Këto specifikime janë formuluar me toleranca jashtëzakonisht të ngushta, shpesh vetëm ± 1 mm ose ± 1 kg, ndërkohë që për disa pozicione si fuqia e motorit (7.1 HP) nuk është lejuar asnjë tolerancë. Një qasje e tillë nuk përfaqëson një tolerancë reale të pranueshme në praktikën industriale dhe mund të përjashtojë operatorët që ofrojnë pajisje funksionalisht të barasvlershme, por me përmasa ose karakteristika minimale devijuese. Kjo bie ndesh me nenin 19.4 të Rregullores për Prokurimin Publik nr. 001/2022, i cili parashtrohet që:

“Përshkrimi i specifikimeve teknike/Termat e referencës do të jenë të qarta, sakta dhe precize dhe duhet të mos paraqesin kufizime të paarsyeshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca.”

Gjithashtu, neni 28.2 i LPP-së përcakton se:

“Autoriteti kontraktues do t’i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik.”

Edhe pse nuk është vërtetuar se specifikimet janë hartuar për të favorizuar një prodhues të caktuar, mungesa e tolerancave reale dhe përqendrimi në vlera të ngurta e bën ofertimin më pak të qasshëm për operatorë të tjerë potencialë, duke kufizuar ndjeshëm konkurrencën.

Kjo situatë bie gjithashtu në kundërshtim me nenin 19.6 të RrPP-së, i cili ndalon referencat kufizuese ndaj prodhimeve apo proceseve specifike, përveç rasteve kur ato janë të shoqëruara me fjalët “ose ekuivalente”. Në këtë rast, mungesa e një hapësire të tillë fleksibiliteti mund të rezultojë në përjashtim të padrejtë të ofertave ekuivalente dhe nuk përmbush standardin e objektivitetit dhe neutralitetit të kërkuar me këtë dispozitë.

Mbështetur në sa më sipër, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi është i bazuar, për shkak të mungesës së tolerancave reale teknike dhe efektit kufizues në pjesëmarrjen konkurruese. Në këto rrethana, AK duhet të rishikojë formulimin e specifikimeve teknike, në mënyrë që të sigurojë balancë ndërmjet kërkesave të prokurimit dhe mundësive reale të tregut për pjesëmarrje të barabartë.

Pretendimi 2

Kjo pikë u pranua pjesërisht nga AK pas kërkesës për rishqyrtim dhe është larguar nga dosja – përfshin kërkesën për agronom të diplomuar (nuk është përshkruar në mënyrë të detajuar në ankesë).

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 2

Pretendimi në lidhje me kërkesën për angazhimin e një agronomi të diplomuar është pranuar pjesërisht nga Autoriteti Kontraktues gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, dhe si rrjedhojë,

kjo kërkesë është larguar nga dosja e tenderit. Meqenëse në ankesë nuk është paraqitur ndonjë zhvillim apo argumentim i mëtijshëm rreth kësaj pike, dhe kërkesa tashmë është eliminuar nga dokumentacioni, eksperti shqyrtues nuk gjen vend për trajtim shtesë në lidhje me këtë pretendim.

Pretendimi Ankimor 3

Ankuesi “AGRIBAU SH.P.K.” konteston kërkesën e AK-së për dorëzimin e A-testeve nga prodhuesi në fazën e ofertimit, së bashku me certifikatën CE ose deklaratën e konformitetit. Sipas ankuesit, kjo kërkesë është e paarsyeshme dhe jo proporcionale, pasi pajisjet mund të mos jenë prodhuar ende në kohën e ofertimit dhe, për rrjedhojë, raportet e A-testeve nuk mund të jenë të gatshme. Ankuesi thekson se certifikata CE është dokument zyrtar që dëshmon përputhshmërinë e produktit me standardet evropiane, dhe se kërkesa për A-test që në këtë fazë është e panevojshme, veçanërisht kur nuk ka ndonjë rrezik të veçantë teknik që ta justifikojë. Më tej, ankuesi përmend se në një tender paraprak të ngjashëm, mungesa e A-testit ishte përdorur si arsye për eliminimin e ofertës së tyre, edhe pse kishin dorëzuar dokumente të tjera të përputhshmërisë. Sipas tyre, kjo dëshmon se kërkesa nuk është vendosur për të verifikuar cilësinë teknike reale, por për të përjashtuar ofertues të caktuar. Po ashtu, A-testet që janë dorëzuar nga ofertues të tjerë në tender janë lëshuar nga një prodhues tjetër nga ai që ka dhënë autorizimin zyrtar për ofertim, gjë që nuk është ndëshkuar nga AK, duke krijuar trajtim të pabarabartë. Në përfundim, ankuesi vlerëson se kërkesa për A-test në fazën e ofertimit është jo proporcionale, e panevojshme dhe kufizuese për konkurrencën, në kundërshtim me nenin 7 dhe 28 të LPP-së dhe kërkon heqjen e saj nga dosja e tenderit.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 3

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes së tenderit dhe pretendimeve të paraqitura nga Operatorit Ekonomik “AGRIBAU SH.P.K.”, eksperti shqyrtues vlerëson si më poshtë: Ankuesi kundërshton kërkesën e AK-së për dorëzimin e A-testit nga prodhuesi në fazën e ofertimit, duke argumentuar se kjo kërkesë është e paarsyeshme dhe vendos barrë disproporcionale ndaj operatorëve ekonomikë, veçanërisht në rastet kur produktet janë të certifikuara me CE dhe ende nuk janë prodhuar në kohën e ofertimit.

Eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se sipas nenit 19.3 të RrPP-së nr. 001/2022, specifikimet teknike mund të përfshijnë karakteristika si testimi dhe metodat e testimit, përfshirë A-testet, nëse ato janë të nevojshme për garantimin e cilësisë. Megjithatë, një kërkesë e tillë duhet të jetë e arsyeshme, proporcionale dhe e justifikuar në raport me objektin dhe rrethanat konkrete të kontratës. Po ashtu, neni 70 i LPP-së përcakton se certifikatat dhe dokumentet e përputhshmërisë duhet të bazohen në standarde përkatëse dhe të lëshohen nga organe të akredituara dhe të pranueshme ndërkombëtarisht.

Në rastin konkret, objekti i kontratës është furnizimi i pajisjeve bujqësore për bujq individualë, me një afat ekzekutimi të shkurtër prej vetëm 15 ditësh, ndërkohë që dosja e tenderit tashmë përfshin kërkesën për certifikatë CE ose deklaratë konformiteti, çka siguron një nivel të konsiderueshëm të kontrollit të cilësisë. Për më tepër, AK ka paraparë edhe sigurinë e ekzekutimit në masën 10% të vlerës së kontratës për një periudhë 8 mujore, e cila përbën një garanci shtesë të rëndësishme për përmbushjen e detyrimeve teknike.

Në këto rrethana, kërkesa për dorëzimin e A-testit në fazën e ofertimit nuk është e justifikuar dhe paraqitet si disproporcionale, duke krijuar një kufizim të panevojshëm për konkurrencën,

veçanërisht nëse konsiderohet se A-testet mund të jenë të pamundura për t'u siguruar në këtë fazë për produkte që ende nuk janë prodhuar. Kjo bie ndesh me nenin 7 dhe nenin 28 të LPP-së, të cilat kërkojnë ruajtjen e konkurrencës dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë. Nëse A-testi konsiderohet vërtet i domosdoshëm për verifikimin e përputhshmërisë teknike, ai mund të parashihet në kushtet e veçanta të kontratës, për t'u dorëzuar gjatë fazës së pranimi të pajisjeve. Në rast të mospërmbushjes së këtij detyrimi nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, AK ka të drejtë të aktivizojë mekanizmin e konfiskimit të sigurisë së ekzekutimit, si masë për mbrojtjen e interesit publik dhe zbatimin e kontratës. Mbështetur në sa më sipër, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi është pjesërisht i bazuar. Edhe pse kërkesa për A-test nuk bie ndesh me dispozitat ligjore, në këtë rast ajo paraqitet si e paarsyeshme dhe disproporcionale, duke vendosur një barrë të panevojshme në fazën e ofertimit, përkundër garancive ekzistuese që mbulojnë rreziqet gjatë zbatimit të kontratës. Në përputhje me nenin 27 të LPP-së, rekomandohet që AK të rishikojë dosjen e tenderit dhe të zhvendosë kërkesën për A-test në kushtet e veçanta të kontratës, duke e kërkuar atë vetëm në fazën e pranimi të pajisjeve.

Pretendimi Ankimor 4

OE ankues kundërshton kërkesën e Autoritetit Kontraktues për dorëzimin e certifikatave ISO 9001:2015, ISO 45001:2018 dhe ISO 14001:2015 nga prodhuesi i pajisjeve. Ankuesi argumenton se këto janë certifikata të sistemit të menaxhimit, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e pajisjeve të ofertës. Sipas tij, nëse kërkesa për këto certifikata konsiderohet e arsyeshme, atëherë ato duhet të vlejnjë për vetë operatorin ekonomik ofertues dhe jo për prodhuesin, pasi një OE mund të ofrojë produkte të certifikuara edhe nëse prodhuesi nuk i zotëron këto standarde. Kërkesa konsiderohet kufizuese, jo proporcionale dhe në kundërshtim me nenin 7 dhe 28 të LPP-së, si dhe me nenin 19.6 të RrPP, për shkak se nuk është paraparë opsioni “ose ekuivalente”.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 4

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues konstaton se AK ka përcaktuar si kërkesë që prodhuesi i pajisjeve të ofertës të posedojë certifikatat ndërkombëtare të sistemit të menaxhimit për cilësi, mjedis dhe siguri në punë, konkretisht: ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018.

Kjo kërkesë nuk ka të bëjë me statusin juridik të operatorit ekonomik ofertues (nëse është vetë prodhues apo vepron si furnizues), por synon të sigurojë që pajisjet që do të furnizohen rrjedhin nga një proces prodhimi të kontrolluar dhe të certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare, që garantojnë cilësi të qëndrueshme, përkujdesje mjedisore dhe kushte të sigurta pune. Standardet e përmendura kanë këtë qëllim dhe përmbajtje:

- ISO 9001:2015 – përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë përgjatë të gjithë ciklit të prodhimit;
- ISO 14001:2015 – lidhet me menaxhimin e ndikimeve mjedisore dhe respektimin e standardeve për mbrojtjen e mjedisit;
- ISO 45001:2018 – rregullon menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës, për të minimizuar rreziqet për punonjësit dhe për procesin prodhues.

Kërkesa për zbatimin e këtyre standardeve përfaqëson një praktikë të zakonshme, sidomos në kontrata publike që lidhen me furnizime, shërbime apo punë të ndryshme, dhe synon të sigurojë jo vetëm cilësinë e produktit final, por edhe përputhshmërinë me praktikën ndërkombëtare të menaxhimit përgjatë procesit të prodhimit. Këto standarde tashmë përbëjnë pjesë të integruar të sistemit të operimit të shumë kompanive prodhuese, prandaj kërkesa për to nuk paraqet një barrë të pazakontë për pjesëmarrësit në tender. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit nuk është evidentuar ndonjë pamundësi objektive për përmbushjen e kësaj kërkesë, qoftë nga OE apo nga prodhuesi i autorizuar.

Për më tepër, kërkesa është formuluar në mënyrë neutrale dhe nuk përmban referenca të drejtpërdrejta ndaj prodhuesve, markave apo origjinave specifike. Standardet ISO janë të hapura, ndërkombëtarisht të pranura dhe aplikohen nga organe të akredituara në vende të ndryshme. Përderisa kërkesa i referohet vetë standardeve dhe jo ndonjë entiteti të kufizuar, ajo nuk bie ndesh me nenin 19.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, i cili ndalon përshkrimet kufizuese vetëm në rastet kur nuk përfshihet mundësia për ekuivalencë.

Po ashtu, kërkesa mbështetet në nenin 70 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili u jep të drejtë autoriteteve kontraktuese që, në funksion të sigurimit të cilësisë, të kërkojnë dokumente të tilla të lëshuara nga organe të pavarura dhe të njohura ndërkombëtarisht, të cilat dëshmojnë përputhshmërinë me standarde të përcaktuara të sistemit të menaxhimit.

Mbështetur në të gjitha sa më sipër, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi është i pabazuar. Kërkesa për dorëzimin e certifikatave ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018 nga prodhuesi i pajisjeve është në përputhje me nenin 70 të LPP-së, është proporcionale, e justifikuar dhe jo-kufizuese, dhe synon të garantojë që produktet që do të furnizohen rrjedhin nga një proces prodhimi i standardizuar, i sigurt dhe i qëndrueshëm.

PËRFUNDIMI

Mbështetur në analizën e pretendimeve dhe dokumentacionit të shqyrtuar, eksperti shqyrtues vlerëson se ankesa e OE “AGRIBAU SH.P.K.” është pjesërisht e bazuar. Ankesa rezulton e bazuar në masën që disa prej specifikimeve teknike të përfshira në Dosjen e Tenderit, përfshirë kërkesat me vlera të fiksuara dhe mungesën e tolerancave reale, janë formuluar në mënyrë potencialisht kufizuese dhe jo plotësisht të justifikuara në raport me natyrën dhe objektin e kontratës, duke cenuar konkurrencën dhe barazinë e trajtimit ndërmjet operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me nenin 28.2 të LPP-së dhe nenet 19.4 dhe 19.6 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Po ashtu, kërkesa për dorëzimin e A-testit në fazën e ofertimit, ndonëse teknikisht e lejueshme, është vlerësuar si jo proporcionale në kontekstin konkret dhe më e përshtatshme për t’u vendosur si obligim në fazën e pranimi të pajisjeve, duke u shoqëruar me mekanizmin e sigurisë së ekzekutimit. Ndërkohë, kërkesa për certifikatat ISO nga prodhuesi i pajisjeve është vlerësuar si e justifikuar, proporcionale dhe në përputhje me nenin 70 të LPP-së, dhe nuk përbën kufizim të pajustifikuar për pjesëmarrësit në procedurë.

Në këto rrethana, eksperti shqyrtues propozon që ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar, Autoriteti Kontraktues të korrigjojë Dosjen e Tenderit në përputhje me nenin 27 të LPP-së, duke përdorur formularin standard B54, si dhe të shtyjë afatin për dorëzimin e ofertave në përputhje me nenin 53.7 të LPP-së, me qëllim që të sigurohen kushte të barabarta dhe konkurrencë reale për të gjithë operatorët e interesuar.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe ja fal besimin raportit të ekspertit shqyrtues. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ritenderim Subvencionimi i fermëve kultivues të perimeve në serra dhe jashtë tyre me pajisje” me numër të prokurimit: 656-25-5673-1-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik AgriBau SH.P.K. aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues duke u bazuar në konstatimet e ekspertit shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ritenderim Subvencionimi i fermëve kultivues të perimeve në serra dhe jashtë tyre me pajisje” me numër të prokurimit: 656-25-5673-1-1-1 që AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim. Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rrjedhimisht paneli shqyrtues konstaton që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së

shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III dhe IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA FERIZAJ**
- **OE - AGRI BAU SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: